REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr5483 Prot

Maliq, më 15.09.2026

VENDIM

Nr 109, datë 15.09.2026

Për

"Miratimin e programit buxhetor afat mesëm të rishikuar për vitet 2027-2029"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika1.1, neni 54 *"Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak"* gërma "dh" nenit 55 *"Votimi"* pika 3, neni 64 *"Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë"* gërma "c", ligjit 9936 datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë"* neni 32 *"Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore"* ligjit 68/2017 *"Për financat e qeverisjes vendore"*, neni 38 *"Programi Buxhetor afatmesëm vendor"*, pika 3, udhëzimi nr.7, datë 27.02.*2026'*, udhëzimit plotësues nr.17 datë 10.07.2026 *"Për përgatitjen e programit buxhetor afat mesëm vendor 2027-2029''* këshilli i bashkisë,

VENDOSI:

I- Të miratojë Projekt-Buxhetin Afatmesëm të Rishikuar për **vitet 2027,2028,2029** për Bashkinë Maliq si më poshtë:

1-Të ARDHURAT

-Buxheti i Pavarur, Transferta e pakushtëzuar, Transerta specifike, Transferta e kushtëzuar në lekë janë:

Viti 2027	1,115,975,000
Viti 2028	1,135,854,000
Viti 2029	1,157,679,000

2 -SHPENZIMET

a-Shpenzimet e Bashkisë Maliq për vitin 2027

- Paga + sigurime	648,819,000
- Shpenzime operative	195,806,000
- Për investime	271,350,000
TOTALI	**1,115,975,000**

b-Shpenzimet e Bashkisë Maliq për vitin 2028

- Paga + sigurime	650,026,000
- Shpenzime operative	204,828,000
- Për investime	281,000,000
TOTALI	**1,135,854,000**

c-Shpenzimet e Bashkisë Maliq për vitin 2029

-Paga + sigurime	652,035,000
-Shpenzime operative	205,494,000
-Për investime	300,150,000
TOTALI	**1,157,679,000**

II-Në hartimin e programit buxhetor afat mesëm të rishikuar për vitet 2027-2029, u morën parasysh mendimet dhe rekomandimet e Ministrisë së Financave .

III-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashki.

IV- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar.

Miratuar me 17 vota
Vota Pro 17
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 15.09.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ